



FONDI KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE
KOSOVSKI FOND ZA KREDITNO JEMSTVO
KOSOVO CREDIT GUARANTEE FUND

RAPORTI VJETOR 2019



TABELA E PËRMBAJTJES

PJESA I, INFORMATA TË PËRGJITHSHME	06
Fjala e Kryesuesit të Bordit dhe Drejtorit Menaxhues	06
Akronimet	08
Përmbledhje e treguesve financiarë	09
PJESA II, PROFILI I INSTITUCIONIT	10
Themelimi dhe statusi i FK GK-së	12
Misioni	12
Vlerat institucionale	13
PJESA III, QEVERISJA KORPORATIVE	14
Bordi i Drejtorëve dhe personeli	16
Struktura organizative	19
Komitetet	20
Komiteti i Menaxhimit të Riskut	20
Komiteti i Auditimit	20
Partnerët e FK GK-së	21
PJESA IV, PERFORMANCA E FK GK-së	22
Zhvillimi i portofolit të garancive	24
Garantimi i agrofinancimit përmes Dritarjes Agro	34
Menaxhimi i riskut kreditor	35
Cilësia e portofolit	36
Struktura e kapitalit dhe investimet	37
Veçoritë e 2019-s	39
PJESA V, AKTIVITETET GJATË VITIT 2019	40
Lidhja e marrëveshjeve të reja	42
Punëtoritë/Seminarët	44
Trajnimet orientuese dhe freskuese me institucionet partnere financiare	46
Mbledhjet e Bordit të Drejtorëve dhe komiteteve përkatëse	47
PJESA VI, PASQYRAT FINANCIARE TË AUDITUARA	48

PJESA I



INFORMATATË PËRGJITHSHME

FJALA E KRYESUESIT TË BORDIT DHE DREJTORIT MENAXHUES

Përderisa po mundohemi t'i zgjedhim fjalët më të mira për ta elaboruar përmbylljen e një viti të suksesshëm të FK GK-së, fokusi dhe mendja na mbetet në situatën e krijuar nga përhapja e pandemisë COVID 19 në mbarë globin, në ndikimin që do ta ketë situata e krijuar në ekonominë e vendit tonë si dhe në rolin që FK GK-ja duhet ta ketë në procesin e rimëkëmbjes ekonomike.

Ndonëse situata aktuale mund ta zbehtë interesimin e lexuesve për t'u informuar për rezultatet e kaluara, ne vazhdojmë të besojmë se aftësia për t'u përballur me të ardhmen gjendet mu në rezultatet që na kanë shoqëruar në të kaluarën. Ne në FK GK, me mbështetjen e fuqishme të partnerëve tanë, jemi të bindur se institucioni jonë tashmë është ndërtuar mbi themele të qëndrueshme që do të na ndihmojnë jo vetëm që ta tejkalojmë situatën aktuale, por edhe ta luajmë një rol aktiv në përmbushjen e misionit tonë themelor, që këto ditë do të përkthejë si mbështetje për rimëkëmbjen e sektorit privat dhe ekonomisë kosovare në përgjithësi.

Të nderuar lexues dhe partnerë, FK GK-ja edhe gjatë vitit 2019 ka vazhduar të zhvillohet dhe ta forcojë pozitën e tij si institucion me rol të rëndësishëm në ekonominë e vendit tonë. Rritja e portofolit të garancive dhe përmirësimi i vazhdueshëm i indikatorëve që tregojnë nivelin e shtueshmërisë ekonomike dhe financiare të skemës sonë garantuere i ka tejkaluar pritjet tona të para një viti. Gjatë vitit 2019, FK GK-ja ka ndërmjetësuar kredidhënie në sektorin privat në vlerë prej 69.1 milionë eurosh për 1,650 NMVM, të mbështetura me një shumë garancie prej 33.5 milionë eurosh. Vlera kumulative e portofolit të kredive të garantuara nga skema garantuere e FK GK-së ka arritur në 156.3 milionë euro, të shpërndara në 4,052 kredi, ndërsa aktiviteti investues në sektorin privat, i mbështetur me këto kredi, ka rezultuar në krijimin e më shumë se 6,000 vendeve të reja të punës në ekonominë e Kosovës.

Sot portofoli ynë ka pjesëmarrje solide të bizneseve të drejtura nga sipërmarrëset gra, rreth 12%, ndërsa inkurajues është edhe niveli i pjesëmarrjes së bizneseve prej 10% nga sektori i agrobiznesit dhe 17% nga sektori i prodhimit. "Dritarja Agro", skemë garantuere kjo e hartuar në bashkëpunim me KfW-në, me qëllim të përmirësimit të mjedisit për investime në sektorin e bujqësisë, është dëshmuar nismë e qëlluar, duke e ndihmuar kreditimin dhe rritjen e pjesëmarrjes së sektorit të bujqësisë në gjithsej portofolin e garancive të FK GK-së, në një shkallë që është dukshëm më e lartë krahasuar me mesataren në sektorin bankar.

Analiza e portofolit të garancive për vitin 2019 tregon një pjesëmarrje të lartë të klientëve të rinj, pa histori të mëparshme kreditore, në përqindje prej 41% në kategorinë e kredive deri në 100,000 mijë euro. Ky është zhvillim inkurajues, meqë me ndërmjetësimin e skemës sonë garantuere i mundësohet për herë të parë qasje në financa edhe kësaj kategorie të ndërmarrjeve, të cilat historikisht janë ballafaquar me sfidat që i shoqëron sindromi i "të qenit i ri në treg".

E njëjta analizë, e cila e trajton ndikimin e skemës garantuere të FK GK-së në mjedisin e jashtëm, shpërfaqë shtueshmëri të theksuar ekonomiko-financiare të skemës sonë garantuere gjatë vitit 2019. Pjesëmarrja e kredive të garantuara në total, përkatësisht e kredive deri në vlerën 100,000 euro që janë disbursuar gjatë vitit 2019, ka arritur në 18%. Ndryshime pozitive vërehen edhe në nivelin e kolateralit të kërkuar, në kohëzgjatjen dhe në volumin mesatar të lejuar, dukshëm më pozitive në kategorinë e kredive të garantuara në krahasim me kreditë e pagantuar.

Bazuar në raportin e fundit të Shoqatës Evropiane të Institucioneve Garantuere (AECM), FK GK-ja i ka tejkaluar skemat garantuere të shteteve të Ballkanit Perëndimor dhe shumë shteteve të BE-së sa i përket ndikimit. Vlera totale e garancive të FK GK-s është

rreth 0.62% e bruto produktit vendor (BPV-së). Ky është sinjal pozitiv drejt ngushtimit të hendeikut të kreditimit në raport me BPV-në e vendit tonë si dhe përmbushjes së mandatit të FKGGK-s për rritjen e qasjes në financa për NMVM-të në vend. Për më shumë, puna e përbashkët e bordit të drejtorëve me menaxhmentin dhe stafin e FKGGK-së ka rezultuar në ngritjen e cilësisë dhe efikasitetit të proceseve që mundësojnë realizimin e operacioneve të brendshme. Përcaktimi dhe përmirësimi i praktikave të menaxhimit të riskut kreditor dhe hartimi dhe avancimi i politikës së menaxhimit të riskut mjedisor dhe shoqëror janë vetëm disa nga shumë ndryshimet pozitive që janë bërë në politikat dhe procedurat e brendshme të institucionit tonë gjatë vitit të kaluar. Krahas kësaj, janë zhvilluar aktivitete të ndryshme me bankat partnere, komunitetin e biznesit dhe publikun e gjerë për ta ngritur vetëdijen për shërbimet dhe rolin e skemës garantuese që e ofron FKGGK-ja. Të gjitha këto janë arritur falë punës së palodhshme që e ka bërë stafi dhe Bordit i Drejtorëve i FKGGK-së.

Për të katërtin vit me radhë, strategjia e investimeve e FKGGK-së vazhdon të kanalizohet në formë të depozitave afatshkurtra dhe afatmesme në bankat vendore. Kjo qasje institucionale e pasqyron besimin e strukturave qeverisëse të FKGGK-së në sektorin bankar të vendit tonë dhe, njëherazi dhe në mënyrë indirekte, duke e rritur likuiditetin në treg, ofron më shumë mundësi për ta ngritur kapacitetin kreditues të bankave lokale.

Viti 2019 shënoi fillimin e një varg bashkëpunimesh me partnerë të rinj për FKGGK-në. Në maj të vitit 2019, FKGGK-ja e lidhi marrëveshjen me EIF – Programin COSME për përdorimin e skemës rigarantuese – me ç'rast vlera e kredive të mbështetura për NMVM-të pritet të arrijë deri në 90,000,000 euro për një periudhë dyvjeçare. Kjo skemë e rigarantimit ka ndikuar drejtpërsëdrejti në ngritjen e kapacitetit garantues dhe para së gjithash e ka shtuar kredibilitetin e FKGGK-së në sektorin financiar. Për më tepër, kushtet e favorshme të skemës rigarantuese të EIF – Programit COSME kanë ndikuar në një përmirësimin të dukshëm të kushteve të garantimit të kredive që i ofron FKGGK-ja në tregun e Kosovës.

Në anën tjetër, në muajin tetor, Fondi e ka lidhur një Marrëveshje për Subjektin Zbatues me Fondacionin Mileniumi i Kosovës, një partneritet ky shumë i rëndësishëm që synon t'i ofrojë FKGGK-së dhe sektorit bankar asistencë teknike për ta krijuar një mjedis në të cilin kreditorët mund të fillojnë t'u japin kredi investorëve privatë për prodhimin e energjisë nga burimet e ripërtëritshme – energjisë solare, risi që deri tani ka munguar në domenin e investimeve private në Kosovë.

Përkundër se kemi lënë mbrapa një vit të suksesshëm, ne do të vazhdojmë të jemi të kujdesshëm dhe proaktivë, posaçërisht në përgatitjen e institucionit për t'u përballur me sfidat që mund t'i sjellë kriza ekonomike që mund të shkaktohet nga pandemia COVID-19. Pasojat negative në ekonomi do të jenë të pashmangshme, ndërsa sa të rënda do të jenë këto pasoja varet, para së gjithash, nga zgjatja e vetë pandemisë, masat preventive që do të merren për ta frenuar përhapjen e pandemisë dhe politikat ekonomike që do të hartohen për t'iu kundërvënë ndikimit negativ në ekonomi. Si FKGGK, ne i ndjejmë efektet e krizës bashkë me sektorin privat dhe atë bankar, shumë prej tyre tashmë klientë ose partnerë tanë. Me ndihmën e donatorëve dhe partnerëve, FKGGK-ja do t'i marrë përgjegjësitë e veta në të gjitha fazat e rimëkëmbjes ekonomike, gjatë krizës dhe pas saj. Është një betejë në të cilën do të hyjmë vullnetarisht, në mënyrë që krizën ta kalojmë së bashku dhe nga ajo të dalim edhe më të fuqishëm.

Për fund, na lejoni që në emër të Bordit të Drejtorëve dhe stafit të FKGGK-së t'i falënderojmë donatorët tanë ndërkombëtarë dhe Qeverinë e Republikës së Kosovës për mbështetjen e vazhdueshme dhënë FKGGK-së. I falënderojmë edhe të gjithë akterët e tjerë, para së gjithash Bankën Qendrore të Kosovës (BQK-në) dhe institucionet financiare partnere për bashkëpunimin e vazhdueshëm. Në të njëjtën kohë, të gjithëve ju dëshirojmë shëndet dhe e presim me padurim edicionin e vitit të ardhshëm të Raportit Vjetor, ku do shkruajmë me krenari, si histori suksesi, mënyrën se si ia kemi dalë ta tejkalojmë sfidën e tanishme.

RINOR GJONBALAJ

Kryesues i Bordit

BESNIK BERISHA

Drejtor menaxhues

AKRONIMET

AECM		Shoqata Evropiane e Institucioneve Garantuese
ASK		Agjencia e Statistikave të Kosovës
BD		Bordi i Drejtorëve
BQK		Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
BPV		Bruto Produkti Vendor
COSME		Konkurrueshmeria e Ndërmarrjeve të Vogla e të Mesme
FKGK		Fondi Kosovar për Garanci Kreditore
EIB		Banka Evropiane për Investime
EIF		Fondi Evropian për Investim
IF		Institucionet Financiar
IFJB		Institucionet Financiare Jobankare
IFP		Institucionet Financiare Partnere
IMF		Institucionet Mikrofinanciare
KfW		Banka Zhvillimore Gjermane
KJP		Kreditë Joperformuese
KMR		Komiteti për Menaxhim të Riskut
KA		Komiteti i Auditimit
MF		Ministria e Financave
MFK		Fondacioni i Mileniumit të Kosovës
MCC		Korporata e Sfidave të Mileniumit
MTI		Ministria e Tregtisë dhe e Industrisë
NMVM		Ndërmarrje Mikro, të Vogla dhe të Mesme
QRK		Qeveria e Republikës së Kosovës
SIDA		Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar
SMMS		Sistemi i Menaxhimit Mjedisor dhe Social
SHBK		Shoqata e Bankave të Kosovës
USAID		Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar

PËRMBLEDHJE E TREGUESVE FINANCIARË

TREGUESIT KRYESORË FINANCIARË	DHJETOR 2018	DHJETOR 2019
KAPITALI	16,286,801	16,771,135
Potenciali garantues	66,434,006	97,397,947
Limitet e alokuara	50,550,000	68,400,000
Shkalla e shfrytëzimit të limiteve nga IPF-të partnere	58.1%	64.16%
BILANCI I GARANCIVE	29,378,984	43,885,949
Nr. i kredive aktive të garantuara	1,984	3,120
Nr. i IF-ve partnere	8	8
Mesatarja e garancive	18,420	18,558
Mesatarja e maturitetit	36	36
KJP (në %)	0.35%	1.29
MBULUESHMËRIA E KJP-SË ME PROVIZIONE (NË %)	289.0%	122.0
KAPITALI I INVESTUAR	15,562,000	16,620,045

Vlerat monetare janë në euro.

PJESA II



PROFILI I INSTITUCIONIT

THEMELIMI DHE STATUSI I FKGK-SË

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore është institucion i pavarur dhe i qëndrueshëm, i cili u lëshon garanci institucioneve financiare për ta mbuluar riskun për kreditë e NMVM-ve. FKGK-ja është themeluar në janar të vitit 2016, bazuar në Ligjin Nr. 05/L-057 për Themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore. Ligji për FKGK-në është sponsorizuar nga MTI-ja, me mbështetjen e USAID-it, përmes programit për "Fuqizimin e Mbështetjes Kreditore" dhe Bankës Gjermane për Zhvillim (KfW). Ligji për FKGK-në ka hyrë në fuqi më 23 janar 2016.

MISIONI

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore është subjekt juridik i pavarur me karakter zhvillimor që ofron garanci kreditore për NMVM-të duke e ndarë riskun kreditor me institucionet financiare. Duke i garantuar portofolet kreditore të institucioneve financiare, ne synojmë ta shtojmë qasjen në financa për NMVM-të, ta mbështesim zhvillimin e ndërmarrësisë dhe prodhimit e shërbimet vendore që sjellin vlerë të shtuar, krijimin e vendeve të reja të punës dhe zhvillimin e përgjithshëm ekonomik.

Ne jemi të përkushtuar ndaj menaxhimit të qëndrueshëm korporativ dhe ndaj përgjegjësisë sociale që vjen me të. Duke i bashkërenduar aktivitetet me partnerët tanë: donatorët, institucionet financiare dhe rregullatorët vendorë, ne përpiqemi t'u shërbejmë interesave afatgjate ekonomike të vendit, komunitetit të biznesit dhe shoqërisë sonë në përgjithësi.



VLERAT INSTITUCIONALE

Vlerat institucionale të FK GK-së, të cilat janë të rrënjosura dhe shërbejnë për ndërtimin e praktikave afariste të përditshme, janë udhërrëfyes për t'u siguruar që aktivitetet tona afariste ta kenë shkallën më të lartë të llogaridhënies dhe të jenë në përputhje me standardet më të larta etike dhe morale ndaj këtyre parimeve.

TRANSPARENCA

Duke qenë institucion me interes publik, FK GK-ja konsideron se është tejet e rëndësishme që informatat për praktikën e punës, politikat dhe rezultatet financiare e operative t'u shpalosen partnerëve, akterëve të tjerë si dhe publikut të gjerë.

PARTNERITETI DHE BASHKËPUNIMI

Ndërtimi i marrëdhënieve të shëndosha të bazuara në transparencë dhe llogaridhënie me partnerët tanë na ndihmon që t'i arrijmë qëllimet tona të përbashkëta dhe ta krijojmë besimin dhe respektin e ndërsjellë.

OBJEKTIVITETI DHE PAVARËSIA NË VENDIMMARRJE

FK GK-ja e ruan objektivitetin dhe pavarësinë e tij në vendimarrje duke u bazuar në arsye dhe parime të shëndosha, duke e promovuar zhvillimin e mëtejshëm të sektorit financiar.

PËRKUSHTIMI

Me përkushtim dhe me profesionalizëm, punonjësit e FK GK-së përpiqen ta realizojnë misionin dhe objektivat e misionit të institucionit, duke besuar në rolin dhe ndikimin pozitiv të institucionit në zhvillimin ekonomik.

PUNA EKIPORE DHE PROFESIONALIZIMI NË PUNË

FK GK-ja e ka një ekip ekspertësh që bashkëpunojnë në baza të respektit të ndërsjellë. Puna ekipore në zgjidhjen e problemeve, komunikimi i hapur dhe ndarja e përvojave profesionale me njëri tjetrin janë gurthemet e suksesit të FK GK-së. Integriteti dhe dinjiteti personal janë vlera të cilave u përmbahet secili punonjës në vazhden e realizimit të detyrave dhe iniciativave në punë, pa bërë asnjë kompromis ndaj këtyre parimeve.



PJESA III



QEVERISJA KORPORATIVE

BORDI I DREJTORËVE DHE PERSONELI

BORDI I DREJTORËVE DHE PERSONELI

FKGK-ja mbikqyret nga një Bord i Drejtorëve që përbëhet nga shtatë (7) anëtarë:

- A. Një (1) anëtar sipas detyrës zyrtare, i emëruar nga ish-Ministria e Tregtisë dhe Industrisë e Republikës së Kosovës;
- B. Një (1) anëtar sipas detyrës zyrtare, i emëruar nga Ministria e Financave e Republikës së Kosovës;
- C. Katër (4) anëtarë të pavarur, të emëruar nga donatorët; dhe
- D. Drejtori Menaxhues i FKGK-së

ANËTARËT E BORDIT TË DREJTORËVE TË FKGK-SË NË VITIN 2019:



RINOR GJONBALAJ

Kryesues i Bordit dhe
anëtar i pavarur i Bordit



ARTA HOXHA

Anëtare e pavarur e Bordit



BESNIK BERISHA

Drejtor Menaxhues i FKGK-së
dhe anëtar i Bordit



KRESHNIK KURTISHI

Anëtar i pavarur i Bordit



MELIH CADIRCI

Anëtar i pavarur i Bordit



NOL BUZHALA

Anëtar i Bordit sipas
detyrës zyrtare -
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë



SALVADOR ELMAZI

Anëtar i Bordit sipas
detyrës zyrtare -
Ministria e Financave

PERSONELI AKTUAL



PERSONELI I FKGGK-SË NË VITIN 2019:

Nga e majta në të djathtë:

BESNIK BERISHA
Drejtor Menaxhues

NORA ARIFI
Menaxhere e Lartë e Garancive

VERË KADRIU
Asistente për Administratë dhe Perkttime


KASTRIOT KËPUSKA
Agro Ekspert

ALBAN KASTRATI
Menaxher i Lartë i Riskut

PARTIN PRUTHI
Zyrtar i Lartë Ligjor dhe Sekretar i Bordit të Drejtorëve

VJOSA KELMENDI
Menaxhere e Lartë për Financa dhe Administratë

STRUKTURA ORGANIZATIVE



KOMITETET

KOMITETI I MENAXHIMIT TË RISKUT

Komiteti i Menaxhimit të Riskut është themeluar sipas Ligjit për FKGK-në. Komiteti i Menaxhimit të Riskut e ndihmon Bordin e Drejtorëve me fokus të veçantë në menaxhimin e riskut. Komiteti i Menaxhimit të Riskut takohet së paku çdo tre muaj dhe përbëhet nga tre (3) anëtarë të Bordit, ndërsa Menaxheri i Lartë i Riskut është anëtar i përhershëm i Komitetit.

Si i tillë, Komiteti i Menaxhimit të Riskut i shqyrton politikat e riskut kreditor dhe operativ, i mbikëqyr zhvillimet e portofolit të garantuar dhe siguron që profili i riskut kreditor të jetë në përputhje me politikat kreditore, ligjet dhe rregulloret në zbatim.

KOMITETI I AUDITIMIT

Komiteti i Auditimit është themeluar sipas Ligjit për FKGK-në. Komiteti i Auditimit përbëhet nga katër (4) anëtarë të Bordit. Komiteti i Auditimit takohet së paku çdo tre muaj.

Komiteti i Auditimit është përgjegjës për dhënien e rekomandimeve Bordit të Drejtorëve për çështjet e menaxhimit të riskut, kontrollit të brendshëm, pasqyrave financiare, kërkesave të pajtueshmërisë, auditimit të brendshëm, auditimit të jashtëm dhe funksioneve të tjera relevante të qeverisjes së FKGK-së. Përveç kësaj, Komiteti i Auditimit i shqyrton kontrollet e brendshme financiare, operative dhe administrative.



PARTNERËT E FKGGK-SË

Për t'i arritur objektivat dhe qëllimet e tij, FKGGK-ja bashkëpunon me institucionet financiare (bankat, IMF-të, IBJF-të), donatorët, Qeverinë e Republikës së Kosovës, Bankën Qendrore të Kosovës dhe Komunitetin e NMVM-ve.

DONATORËT

- Qeveria e Republikës së Kosovës
- Agjencia Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID)
- Banka Zhvillimore Gjermane (KfW)

PARTNERËT

- Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe për Bashkëpunim Ndërkombëtar – SIDA, e përfaqësuar nga Ambasada Suedeze
- Fondi Evropian i Investimeve
- Korporata e Sfidave të Mileniumit/Fondacioni Mileniumi i Kosovës

INSTITUCIONET PARTNERE FINANCIARE

- | | |
|----------------------------|-----------------------------|
| • Banka Ekonomike | • ProCredit Banka |
| • Banka Kombëtare Tregtare | • Raiffeisen Bank |
| • Banka për Biznes | • TEB |
| • NLB Banka | • Raiffeisen Leasing Kosovë |

PJESA IV



PERFORMANCA E FKGGK-së


ZHVILLIMI I PORTOFOLIT TË GARANCIVE

RRITJE E SHPEJTË ME CILËSI TË LARTË


Viti 2019 ishte një vit tjetër i suksesshëm për FKGK-në, i cili vazhdoi të ofrojë garanci kreditore për NMVM-të, duke e ndarë rrezikun kreditor me institucionet financiare në një nivel edhe më të lartë se në vitet e mëparshme.

Asimetria e informacionit, mungesa e kolateralit dhe pasojat e saj nënkuptojnë që huadhënësit kërkojnë ta minimizojnë riskun e tyre, andaj edhe kërkojnë mbështetje të garancisë kreditore.

Gjatë vitit 2019 në sajë të ndërmjetësimit të FKGK-së, është mundur kredidhënie në sektorin privat në vlerë prej 69.1 milionë eurosh, të shpërndara në 1,790 kredi dhe të mbështetura me një shumë garancie prej 33.5 milionë eurosh. Shuma kumulative e kredive të miratuara në fund të vitit e ka arritur vlerën prej 156.3 milionë eurosh për 4,052 kredi, të mbështetura nga një shumë kumulative e garancive prej 75.2 milionë eurosh.



Vlera totale e mbetur e portofolit të kredive në fund të vitit 2019 ishte 90.7 milionë euro, ndërsa vlera totale e mbetur e portofolit të garantuar ishte 43.88 milionë euro.



RRETH 99% E PORTOFOLIT PËRBËHET NGA NDËRMARRJET E VOGLA

Portofoli i garantuar vazhdon të ketë pjesëmarrje më të madhe të ndërmarrjeve mikro. Përqendrimi i portofolit të garantuar sipas numrit të punëtorëve është si vijon (shih Tabelën 1):

Tabela 1. Përqendrimi i portofolit të garantuar sipas numrit të punëtorëve

KATEGORITA	KRITERET	TOTALI
Mikro	deri 9	87%
E vogël	10 - 49	12%
E mesme	50 - 249	1%


Siç mund të shihet nga Tabela 1, 87% e kredive të garantuara u takojnë ndërmarrjeve me numër të të punësuarve deri në 9. Një shpërndarje e tillë e portofolit të garancisë kreditore të FKGGK-së është në përputhje me dinamikën e zhvillimit në treg, kërkesat që vijnë nga sektori privat dhe bankar, por edhe orientimin e institucionit tonë drejt qasjes në financa për këtë segment.

GAMA E GJERË E SEKTORËVE TË EKONOMISË QË PËRFITOJNË NGA GARANCITË

Stimulimi i sektorët që krijojnë vlerë të shtuar për ekonominë është njëra nga objektivat tona dhe për këtë qëllim FKGGK-ja, me mbështetjen e donatorëve dhe partnerëve të saj, është duke punuar në drejtim të fuqizimit të sektorëve strategjikë.


Viti 2019 ka vazhduar ta ndjekë trendin e njëjtë sikurse viti i kaluar, duke e pasqyruar një gamë të gjerë të sektorëve të ekonomisë që përfitojnë nga garancitë.

KREDITË SIPAS SEKTORËVE



Sektori më dominues në portofolin e kredive të garantuara gjatë vitit 2019 ishte ai i tregtisë me pakicë dhe me shumicë me 34%, i pasuar nga sektori i shërbimeve me 28%, prodhimit me 16%, bujqësisë me 14% dhe ndërtimtarisë me 8%. Krahësuar me një vit më parë, kemi një lëvizje të moderuar nëpër sektorë, posaçërisht në sektorin e bujqësisë.

Për vetëm tri vite të operimit, FK GK-ja e ka ndërtuar një portofol me një strukturë dukshëm më të favorshme se struktura e ekonomisë reale në Kosovë dhe struktura e portofolit kreditor në sektorin bankar.



Siç mund të shihet nga grafiku i mësipërm, FK GK-ja ka pjesëmarrje dukshëm më të lartë të kredive aktive nga sektori i prodhimit dhe bujqësisë, të cilët konsiderohen si sektorët më strategjikë të ekonomisë, krahasuar me portofolin kreditor në nivel të sektorit bankar.


Në FK GK, bujqësia ka pjesëmarrje me 10.6%, ndërsa në nivel të sektorit bankar ky aktivitet ekonomik është dukshëm më pak i përfaqësuar, me vetëm 3.7 %, përderisa një situatë të ngjashme e kemi edhe me sektorin e prodhimit, ku në FK GK ky sektor është i përfaqësuar me një pjesëmarrje prej 17%, ndërsa në nivel të sektorit bankar kjo pjesëmarrje është dukshëm më e ulët, me vetëm 13.7%.

Stimulimi i sektorëve që krijojnë vlerë të shtuar për ekonominë, siç është bujqësia dhe prodhimtaria, është njëra nga objektivat tona, prandaj FK GK-ja po bashkëpunon me partnerët e tij në drejtim të fuqizimit të këtij sektori dhe sektorëve të tjerë më pak të shërbyer, të cilët konsiderohet se janë forca shtytëse e ekonomisë dhe kontribuues gjithnjë e më të mëdhenj të punësimit dhe mirëqenies sociale më të madhe në përgjithësi.

MBIZOTËRIMI MË I LARTË I INVESTIMEVE KAPITALE

Edhe ky vit u karakterizua me investime në asete fikse (pajisje dhe ndërtim, renovim, tokë). Veç kësaj, investimet në kapital punues kishin pjesëmarrje domethënëse në portofolin e garantuar.


Në vitin 2019, 27% e kredive të aprovuara janë investuar në pajisje (makineri të prodhimit, pajisje bujqësore, pajisje të tjera); 19% në tokë, ndërtim ose rinovim; 36% në kapital punues dhe 18% në të tjera.



SHFRYTËZIMI I GARANCIVE NË RAJONE TË NDRYSHME

Shfrytëzimi i garancive në rajone të ndryshme në vitin 2019 e përcolli trendin e viteve paraprake. Rajoni i Prishtinës kishte përqindje më të madhe në portofolin e kredive të garantuara me një pjesëmarrje prej 54%.

Konsiderohet se një shpërndarje e tillë e portofolit është në përputhje me shpërndarjen e portofolit të kredive të sektorit bankar në rajonet përkatëse.



SHTUESHMËRIA

Shtueshmëria është arsyeja kryesore për themelimin e FK GK-së. Kjo do të thotë se bankat, institucionet mikrofinanciare ose institucionet financiare jobankare nuk do t'i kishin dhënë kredi një NMVM-je pa garancinë e dhënë, duke shtuar kështu një klient të ri dhe duke kontribuar në rritjen ekonomike.

Për ta parë ndikimin, FK GK-ja i ka monitoruar dhe analizuar indikatorët e ndërlidhur me shtueshmërinë financiare dhe ekonomike edhe në vitin 2019. Rezultatet e monitorimit të këtyre indikatorëve na kanë treguar se si aktiviteti i FK GK-së në përgjithësi i ka kontribuar një qasjeje të përmirësuar në financa, standardeve të relaksuara të kredidhënies dhe performancës së përmirësuar të NMVM-ve, siç është paraqitur në tekstin e mëposhtëm.

PJESËMARRJA E KREDIVE TË GARANTUARA NË SEKTORIN BANKAR


Ky tregues, edhe këtë vit, tregon një rritje të pjesëmarrjes së kredive të garantuara në sektorin bankar. Kjo rritje nënkupton ndikimin e FK GK-së në aktivitetin e kredidhënies në sektorin bankar e që për NMVM-të nënkupton qasje më të mirë në financa.

Në vitin 2019, kjo pjesëmarrje në kategorinë e kredive deri në 100,000 euro ishte 18%, ndërsa vetëm në kategorinë 25,000-50,000 euro ishte 22%.

Ky tregues shënoi rritje për 29% krahasuar me vitin 2018, kur pjesëmarrja ishte 14%. Një rritje e tillë tregon se skema e garancisë kreditore e FK GK-së e ka shtuar më tej ndikimin pozitiv në ndërmjetësimin financiar.

Arsyeja e pasqyrimin në kategorinë deri në 100,000 euro është fakti se profili i klientëve në portofolin e FK GK-së i takon këtij segmenti në treg.

PJESËMARRJA E FK GK-SË NË SEKTOR (vlerë financiare)




MESATARJA E MATURITETIT TË KREDISË - KOHËZGJATJE MË E LARTË E KREDIVE

Portofoli i garantuar gjatë vitit 2019 vazhdoi të përbëhej nga kreditë afatmesme me një mesatare prej 36 muajsh. Mesatarja e maturitetit të kredisë si tregues i shtueshmërisë financiare edhe këtë vit tregoi rritje të maturitetit të kredive të garantuara krahasuar me kreditë e pagantuara. Rritja e maturitetit nënkupton kushte më të mira të financimit për kredimarrësit, ndërsa risk më të lartë për kredidhënësit.

Afati mesatar i kredive të garantuara deri në 100,000 euro ishte 38 muaj apo për 23% më i lartë se mesatarja e kredive të pagantuara.

Ky indikator, edhe gjatë vitit 2019, edhe gjatë vitit 2018, rezultoi në standarde më relaksuese të riskut nga ana e IFP -ve, prandaj edhe në kushte më të mira të kredimarrjes për NMVM-të, ndërsa për NMVM-të çdo rritje e maturitetit do ta rrisë kapacitetin e kredimarrësit për ta kompletuar investimin e planifikuar.


MESATARJA E MATURITETIT TË KREDISË



MBULUSHMËRIA ME KOLATERAL

Kolaterali është shumë shpesh njëra nga arsyet e refuzimit të kërkesës për kredi ose njëra nga arsyet e zvogëlimit të shumës së kredisë në kërkesë. Prandaj, në kuptim të ndikimit të skemës së garancive, kërkesa më e ulët për kolateral nënkupton para së gjithash përfshirje financiare me kushte më të mira të kredidhënies për klientët, kohë më të shkurtër për procedimin e kërkesave për kredi dhe kosto më të ulët të huamarrjes. Analiza e vitit 2019 rezultoi me një ndikim pozitiv të skemës së garancisë së FK GK-së, duke e zvogëluar kështu kërkesën për kolateral për 66%.


ZVOGËLIMI I KËRKESËS PËR KOLATERAL



SHUMA MESATARE E KREDISË

Në fund të vitit 2019, portofoli i FK GK-së është populluar nga ndërmarrjet e vogla me vlerë mesatare të kredive prej 38,000 euro. Kjo vlerë përputhet me kategorinë e vogël të ndërmarrjeve që kanë mungesë të kolateralit, prandaj edhe kanë nevojë për mbështetje financiare.


Po ashtu, ky vit rezultoi me shumë mesatare më të lartë të kredive të garantuara për 30%, në krahasim me kreditë e pagarantuara në kategorinë e kredive deri në 100,000 euro. Ngritja e shumës mesatare të kredisë përmes ndërmjetësimit të FK GK për këtë kategori e pasqyron ndikimin e skemës së garancive në standarde më të mira të kredihënies nga ana e bankave gjatë procesit të aprovimit të kredive.



KLIENTËT E RINJ/PËRFSHIRJA FINANCIARE

Pjesëmarrja më e lartë e kësaj kategorie të klientëve (të cilët nuk kanë marrë kredi asnjëherë) në portofolin e përgjithshëm të klientëve të kredisë nënkupton perceptim më të ulët të riskut nga bankat në raport me ndërmarrjet e sapokrijuara, pra nivel më të lartë të përfshirjes financiare për bizneset e reja.

Pjesëmarrja e kredive të garantuara për bizneset e reja pa përvojë të mëparshme në kredimarrje në vitin 2019 në kategorinë e kredive deri në 100,000 euro ishte për 41%, përderisa pjesëmarrja e kredive të pagarantuara e të njëjtit segment ishte 27%. Ky përpjesëtim e pasqyron ndikimin e FK GK-së në përfshirjen financiare të sektorit privat pa përvojë të mëparshme në kredimarrje, prandaj edhe ndikimin pozitiv në sektorin financiar dhe në ekonomi në përgjithësi.



PJESËMARRJA E BIZNESEVE TË GARANTUARA NË RAPORT ME TË GJITHA BIZNESET AKTIVE NË EKONOMINË REALE

Pjesëmarrja e kredive të garantuara nga FKGK në gjithsej bizneset taksapaguese është tregues tjetër i rëndësishëm i përfshirjes së NMVM-ve në skemën e garancive.

Bazuar në informatat që janë siguruar nga Administrata Tatimore e Kosovës, në vitin 2019 kishim përafërsisht 53,203 biznese aktive, ndërsa numri i NMVM-ve të cilat përfituan nga garancitë kreditore të FKGK-së deri në 2019 ishte 3,456, duke e sjellë pjesëmarrjen e NMVM-ve të garantuara në sektorin e NMVM-ve në 6.5% në fund të vitit 2019. Kjo pjesëmarrje është duke u rritur nga viti në vit, duke e pasqyruar kështu rëndësinë e FKGK-së si dorë e zgjatur për zhvillimin e sektorit të NMVM-ve dhe ekonomisë në përgjithësi.

PJESËMARRJA E VËLLIMIT TË KREDIVE AKTIVE TË GARANTUARA NGA FKGK-JA NË BPV


Për ta kuptuar rëndësinë e instrumentit të garancive të FKGK-së në ekonominë kombëtare, ne e kemi llogaritur pjesëmarrjen e vëllimit të kredive aktive të garantuara nga FKGK-ja në BPV deri në fund të vitit 2019. Në fund të vitit 2019, kjo pjesëmarrje ishte 0.62%, duke shënuar rritje prej 21% krahasuar me vitin 2018 (në fund të vitit 2018 ky përpjesëtim ishte 0.51%).

Krahasuar me shtetet e Evropës Qendrore dhe Lindore skemat garantuese të të cilave janë anëtare të AECM-s, Kosova, gjatë tri viteve të shkurtra të operimit, e ka arritur pothuaj mesataren e këtyre shteteve (0.71%, sipas AECM-së), i ka kaluar skemat garantuese të shteteve të Ballkanit Perëndimor dhe qëndron në pozitë relativisht më të mirë se shumica e skemave të garantimit të kredive, përkundër faktit se shumica e këtyre shteteve kanë përvojë të gjatë me skema garantuese, nëse krahasohen me Kosovën. Një rritje e tillë e pjesëmarrjes së vëllimit të kredive të garantuara në totalin e volumit të kredive në këtë sektor (kreditë për NMVM-të) dhe në BPV-në e Kosovës është sinjal pozitiv drejt ngushtimit të hendekut të kreditimit në raport me BPV-në e vendit tonë.

RRITJA E PARASHIKUAR E QARKULLIMIT VJETOR

Realizimi i investimeve krahas qasjes në financa duhet të rezultojë në rritje të qarkullimit të ndërmarrjeve përfituese. Gjatë vitit 2019, kjo ka ndodhur edhe me ndërmarrjet që kanë qenë përfituese të garancive. Deri në fund të vitit 2019, janë aprovuar 1,790 kredi për NMVM-të me vëllim prej 69.1 milionë eurosh, prej nga, si rezultat i investimeve të realizuara, rritja e parashikuar e qarkullimit mbi qarkullimin bazë ishte 72.9 milionë euro, apo 11% mbi bazën aktuale.



RRITJA E QARKULLIMIT VJETOR (E PARASHIKUAR)



NUMRI I PARASHIKUAR I VENDEVE TË REJA TË PUNËS

Krijimi i vendeve të reja të punës është njëra nga objektivat kryesore të themelimit të FKGK-së. Si rezultat i investimeve që janë bërë nga kreditë falë mbështetjes nga skema e garancive e FKGK-së, gjatë 2019, nga 1,790 kredi të aprovuara, janë parashikuar 2,803 vende të reja të punës apo një rritje prej 28% mbi bazën aktuale.

Siç mund të shihet nga dhe grafi në vijim, këto vende të reja të parashikuara të punës gjatë vitit 2019 vijnë kryesisht nga sektori i tregtisë dhe ai i shërbimeve, me 64%.




KREDITË PËR GRATË NË BIZNES

Ky tregues fokusohet në përfshirjen e grave pronare të NMVM-ve në procesin e kredimarrjes.

Gratë ndërmarrëse marrin pjesë në kredimarrje formale në një shkallë më të ulët se burrat ndërmarrës. Për shkak të kësaj, FKGK-ja e ka caktuar si objektiv institucionale ofrimin e mundësive më të mira për sektorët ekonomikë dhe kategoritë e popullatës më pak të shërbyer, duke përfshirë gratë.

Gjatë vitit 2019, pjesëmarrja e kredive për gratë ndërmarrëse ishte 13%. Kjo pjesëmarrje shënoi rritje në krahasim me vitin paraprak. Rritja e pjesëmarrjes është mesazh se ndikimi i garancisë kreditore të FKGK-së ka filluar të shihet edhe në këtë segment të synuar.

PJESËMARRJA E GRAVE PRONARE



GARANTIMI I AGROFINANCIMIT PËRMES DRITARES AGRO

Bankat e konsiderojnë Dritaren Agro si mundësi të mirë për garantimin e kredive agro, marrë parasysh specifikat e këtij sektori dhe vështirësitë e ofrimit të kolateralit për pronat e paluajtshme në zonat rurale, kryesisht për shkak të paqartësive që ndërliken me të drejtat pronësore.

Bankat ende e konsiderojnë financimin e sektorit të bujqësisë si të ulët në raport me financimin e sektorëve tjerë. Në fund të vitit 2019, ky sektor mori pjesë me 3.7 % të kredive aktive të bankave, çfarë paraqet një rënie prej 0.2% krahasuar me vitin paraprak. Kjo pjesëmarrje në financim nuk korrespondon me pjesëmarrjen që ky sektor e ka në BPV (sipas ASK-së 7.9% në vitin 2018 dhe 6.8% në vitin 2019). Rënia e pjesëmarrjes në financim vjen edhe si rrjedhojë e rritjes së pjesëmarrjes në sektorët e tjerë. Informaliteti i fuqisë punëtore, krahas migrimit të fuqisë punëtore jashtë vendit, konsiderohet se është njëra nga arsyet për këtë shkallë të financimit nga bankat në sektorin e bujqësisë.

FKGK-ja, përmes Dritares Agro së saj, e ka mundësuar garantimin e më shumë se 9.7 milion eurove për kreditë agro. Ndër efektet pozitive të garantimit të këtyre kredive është edhe fakti se gjatë vitit 2019 në sektorin bankar janë financuar gjithsej 60.2 milionë euro, apo 11.9 milionë euro (24.7 %) më shumë për kreditë agro krahasuar me vitin paraprak (48.3 milionë euro).

Bazuar në të dhënat që janë raportuar nga bankat partnere, është evidentuar se garantimi i financimit të këtyre kredive agro ka ndikuar në krijimin e 355 vendeve të reja të punës në këtë sektor.

Përkrahja që ky sektor e merr nga FKGK-ja do të fuqizohet akoma më shumë përmes zotimit të Bankës Gjermane për Zhvillim (KfW-së) për ta përkrahur këtë lloj të mbështetjes duke i siguruar FKGK-së kapital shtesë. Kjo do ta siguronte financimin e më shumë se 69 milionë eurove për kreditë agro nga ana e sektorit bankar.



MENAXHIMI I RISKUT KREDITOR

Veprimtaria e FKGK-së ndërlidhet me marrjen e riskut në dhënien e garancive kreditore të pjesshme për NMVM-të, të cilat janë vlerësuar nga institucionet partnere financiare (IFP -të). Si rrjedhojë, risku kreditor që buron nga asimetria e informatave, mungesa e koleteralit apo rreziqet e tjera gjatë kreditimit të NMVM-ve bëhet po ashtu pjesë e riskut të FKGK-së për kreditë e garantuara.

Qasja e FKGK-së për menaxhimin e riskut është gjithëpërfshirëse dhe fillon nga identifikimi dhe analizimi i rreziqeve me të cilat përballet FKGK-ja për të vazhduar pastaj me përcaktimin e kontroleve të duhura për menaxhimin e riskut dhe ndërtimin e një sistemi adekuat të monitorimit. Strategjia e FKGK-së për menaxhimin dhe zbutjen e riskut zbatohet përmes:

- kufizimit të ekspozimeve në nivel të përgjithshëm, në nivel të IFP-ve si dhe ndaj NMVM-ve (duke ndikuar indirekt në diversifikimin e portofolit të garantuar);
- përcaktimit të kushteve dhe kritereve kualifikuese të qarta, prej nga, në rast të moszbatimit nga ana e IFP -ve, FKGK-ja e ka mundësinë e anulimit të detyrimeve deri në plotësimin e kushteve që kërkohen nga FKGK-ja;
- rigarantimit të portofolit nga skema garantuese e institucioneve kredibile, duke e mundësuar ndarjen e riskut nga kreditë e garantuara;
- monitorimit periodik të zhvillimeve në sektorin financiar, monitorimit të IFP -ve si dhe monitorimit të performancës së klientëve të garantuar.

Në përputhje me politikat dhe proceset e brendshme, FKGK-ja i ka shqyrtuar dhe miratuar kërkesat për rivlerësimin e limiteve të pothuaj të gjitha IFP -ve gjatë vitit 2019 dhe i ka filluar pagesat e para të kërkesave për kreditë e kualifikuara për garantim nga FKGK-ja.

Përveç kësaj, gjatë vitit të kaluar, FKGK-ja e ka vazhduar praktikën e mbledhjeve të rregullta mujore për t'i analizuar trendet në sektorin bankar në përgjithësi dhe për secilin IFP në veçanti, krahas analizimit të portofolit të garancive. Monitorimi dhe analizimi i këtyre trendeve është njëri ndër rolet më të rëndësishme të FKGK-së që e mundëson identifikimin e problemeve potenciale dhe menaxhimin e tyre në një fazë të hershme.


Gjatë vitit 2019, FKGK-ja e ka shfrytëzuar tërë limitin e ndarë nga skema rigarantuese e SIDA-s, e cila e ka mundësuar ndarjen e riskut prej 50%, në vlerën e limit rigarantues prej 9.51 milionë eurove. Veç kësaj, gjatë vitit 2019, FKGK-ja ka filluar të bashkëpunojë me EIF-në duke e nënshkruar një marrëveshje për skemën rigarantuese COSME, që po ashtu e ofron mundësinë e ndarjes së riskut përmes mbulimit në shkallë prej 50% të kredive të garantuara nga FKGK-ja që kualifikohen për Programin COSME. Skemat rigarantuese ia kanë mundësuar FKGK-së ndarjen e pjesshme të riskut kreditor, rritjen e kapacitetit garantues, por edhe uljen e shpenzimeve të provizionit.

Me qëllim të mbulimit të humbjeve që mund të paraqiten nga garancitë, FKGK-ja ka vazhduar t'i provizionojë garancitë. FKGK-ja e bën zhvlerësimin e garancive në tri faza, të cilat bazohen në klasifikimin kreditor të klientit sipas të dhënave që merren çdo muaj nga IFP -të e regjistruara.

CILËSIA E PORTOFOLIT


Më 31 dhjetor 2019, bilanci garantues i FKKG-së ishte në vlerë prej 43.88 milionë euro, ku delikuenca në portofolin e garantuar ishte 1.50%, ndërsa KJP ishte 1.29%. Përkundër përkeqësimit të cilësisë së portofolit krahasuar me vitin paraprak, cilësia e tij ishte në nivelin e parashikuar, meqë FKKG-ja hyri në vitin e katërt të operimit dhe pritjet janë që performanca e kredive të garantuara t'i përafrohet segmentit të cilin e garanton. Në vitin 2019 janë paguar gjithsej katër (4) kërkesa për kreditë e garantuara ndaj tri IFP-ve, që shënon vitin e parë të paraqitjes dhe pagesës së kërkesave të tilla. Vlera e tyre ishte 82,300 euro, që në raport me bilancin e garantuar ishte 0.19%.

CILËSIA E PORTOFILIT TË GARANCIVE



FKKG-ja e vijoi ndërtimin e rezervave të provizionit sipas modelit të humbjeve të pritura, ku deri me 31 dhjetor 2019 gjithsej rezervat e provizionit ishin 688,229 euro, që paraqet mbulueshmëri prej 1,6% në raport me bilancin e garantuar, përdërisa mbulueshmëria e KJP-së ishte 122%.

BILANCI KUNDREJT PROVIZIONIMIT




STRUKTURA E KAPITALIT DHE INVESTIMET

Kapitali i FKGG-së përbëhet nga fondet e dhuruara për FKGG-në nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe nga donatorët. Në vitin 2016, kur edhe është themeluar FKGG-ja, shuma e kapitalit të dhuruar të FKGG-së ishte 7,345,141 euro, ndërsa gjatë vitit 2017 kjo shumë është dyfishuar, duke e mbyllur vitin 2017 me kapital të dhuruar në shumën prej 15,790,921 eurove. Dyfishimi i kapitalit ishte rezultat i kontributit në donacione nga USAID-i, MTI-ja dhe KfW-ja, në fund të muajit dhjetor 2017. Gjatë viteve 2018 dhe 2019, FKGG-ja nuk ka pranuar kapital të ri nga donatorët apo Qeveria e Republikës së Kosovës, por ka punuar në mënyrë intensive në zhvillimin e disa projekteve, të cilat pritet të rezultojnë në kapital apo donacione në të ardhmen e afërt.

Tabela 2. Struktura e kapitalit

	MTI	USAID	KFW	FITIMI I AKUMULUAR	TOTAL
KAPITALI 2016	2,000,000	5,345,141	-	(3,149,00)	7,341,922
KAPITALI 2017	1,000,000	445,780	7,000,000	179,017.00	8,624,797
KAPITALI 2018	-	-	-	320,012	320,012
KAPITALI 2019	-	-	-	484,334	484,334
GJITHSEJ	3,000,000	5,790,921	7,000,000	980,214	16,771,135
%	18%	35%	42%	6%	100%

Vlerat monetare janë në euro.



FKGK-ja e përdor një politikë të levërimit të kapitalit të saj që përcaktohet varësisht nga indikacionet e riskut në treg/sector, duke u siguruar që FKGK-ja të ketë kapital të mjaftueshëm për ta kryer aktivitetin e saj dhe për t'i absorbuar humbjet e mundshme.

Rritja e kapitalit të dhuruar ka ndikim direkt në dy burimet kryesore të të ardhurave të FKGK-së. Rritja e shumës së garancive të lëshuara, si njëri nga dy burimet kryesore të financimit institucional, ndikon edhe në rritjen e të hyrave të FKGK-së përmes tarifës që paguhet nga ana e bankave. Kjo tarifë përcaktohet në bazë të analizave të tregut dhe i pasqyron humbjet e parashikuara për garancitë e lëshuara.

Burimi tjetër kryesor i të ardhurave për FKGK-në është interesi ose të ardhurat nga investimet e kapitalit të FKGK-së.

Fondi i kapitalit të FKGK-së investohet në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-057 për Themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore dhe Politikën e Investimit, të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve, për ta mbrojtur kapitalin e FKGK-së dhe për t'i mbështetur kështu garancitë, si dhe për të sjellë të hyra mbështetëse për qëndrueshmërinë e FKGK-së dhe për ta ruajtur likuiditetin adekuat.


Menaxhimi efektiv i riskut të likuiditetit është thelbësor për ta ruajtur besimin e donatorëve dhe të IFP-ve dhe për të mundësuar që veprimtaria bazë të vazhdojë të sjellë të ardhura, madje edhe në rrethana të pafavorshme.

FKGK-ja është e angazhuar në përdorimin e teknikave të përshtatshme të matjes së performancës që e balancojnë riskun dhe shpërblimin brenda kontekstit të menaxhimit efektiv të riskut. Për qëllimet e optimizimit të kthimeve potenciale brenda parametrave të pranueshme të riskut, FKGK-ja e ka hartuar një politikë të investimit, e cila e përcakton qartë një strukturë të investimeve që është në përputhje me mandatin e FKGK-së dhe objektivat strategjike të tij.

Gjatë vitit 2019, FKGK-ja i ka investuar 16,620,045 euro në depozitat me afat me institucionet partnere financiare të FKGK-së, me maturitet njëvjeçar dhe dyvjeçar, duke e zgjeruar kështu bashkëpunimin edhe në këtë drejtim.

Të ardhurat konsolidohen në Pasqyrën e të Ardhurave dhe fitimi i vitit riinvestohet ose mbahet në FKGK duke rritur kapitalin dhe nuk shpërndahet jashtë FKGK-së në asnjë formë ose mënyrë, duke përfshirë edhe dividendin.

DEPOZITAT ME AFAT SIPAS MATURITETIT



VEÇORITË E 2019-S

FKGK PJESË E PROGRAMIT COSME

Pas ratifikimit të marrëveshjes COSME në Kuvendin e Kosovës në gusht të vitit 2018, institucioneve financiare në Kosovë iu dha mundësia që të aplikojnë në Programin COSME.

Njëra nga objektivat kryesore të COSME-s është që të ofrojë qasje më të madhe në financim për NVM-ve në faza të ndryshme të ciklit jetësor të tyre, siç është: themelimi, zgjerimi apo transferimi i biznesit. Një objektivë e tillë, e cila është në përputhje me objektivat e Institucionit tonë, e inkurajoi asokohe FKGK-në që ta shfrytëzonte mundësinë dhe të shprehte interesim për të aplikuar në Programin COSME.

Kjo iniciativë u kurorëzua në maj të vitit 2019, kur FKGK dhe EIF, pjesë e Bankës Evropiane për Investime (EIB), e nënshkruan Marrëveshjen e Garancisë së Programit COSME të Bashkimit Evropian për mbështetje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM), duke e bërë kështu FKGK-në kandidatën e parë nga Kosova me një transaksion të miratuar në kuadër të COSME Instrumentit për Garantimin e Kredive.

Si kandidati i parë nga Kosova me një transaksion të miratuar në kuadër të COSME Instrumentit për Garantimin e Kredive, për një periudhë dyvjeçare, FKGK-ja pritet ta mbështesë vlerën e kredive deri në 90,000,000 euro për NVM-të. Qëllimi i lidhjes së një marrëveshje të tillë është transferimi deri në 50% i riskut kreditor mbi shumën e mbetur të pjesës së garantuar. Një qëllim i tillë ndërlidhet me një varg dobish që ky Program do t'u sillte të gjitha palëve përkatëse.

Krahas ndarjes së riskut kreditor me një institucion kredibil siç është EIF, Institucioni ynë do të përfitojë nga avancimi i mëtejshmë i qëndrueshmërisë financiare, reputacionit dhe kredibilitetit. Një ngritje e tillë e kredibilitetit do të thotë rritje e qasjes në financa për NVM-të, rritje e investimeve në sektorin privat, rritje e aftësisë konkurruese për ndërmarrjet kosovare, përmirësim i bilancit tregtar, rritje e punësimit dhe rritje e zhvillimit ekonomik në përgjithësi.

MARRËVESHJA PËR ZBATIM PËR ENERGJINË E RIPËRTËRITSHME

Më 03 tetor 2019, Fondacioni i Mileniumit të Kosovës (MFK) i mbështetur nga Korporata e Sfidave të Mileniumit (MCC) ka nënshkruar Marrëveshjen për Zbatim me Fondin Kosovar për Garanci Kreditore, për ngritjen e ekspertizës dhe krijimin e Dritares për Garanci të Kredihënies për Projekte dhe për Energji të Ripërtëritshme. Marrëveshja shënon një hap drejt një zhvillimi të rëndësishëm duke synuar rritjen e kreditimit dhe investimeve në sektorin e energjisë solare e me këtë mbështetjen e energjisë së ripërtëritshme në Kosovë e cila do të ndihmojë zhvillimin ekonomik të Kosovës dhe do të ndikojë në përmirësimin e ambientit në Kosovë.

Kjo marrëveshje fokusohet në tri intervenime kyçe që kanë për qëllim financimin e energjisë së ripërtëritshme në Kosovë:

1. Sigurimi i asistencës teknike dhe zhvillimi i kapaciteteve për krijimin e një dritare garantuese për financimin e projekteve të energjisë së ripërtëritshme;
2. Përsheptimi i projekteve investive në energji të ripërtëritshme – solare, të gatshme për financim bankar, përmes kontrollimit të cilësisë së dokumentacionit dhe përmbushjes së kërkesave standarde nga bankat;
3. Standardizimi i tregut përmes një pakete ku përfshihen trajnime dhe standardizim i projekteve për të ndihmuar bankat partnere të FKGK-së të vlerësojnë faktorët e riskut gjatë vlerësimit të projekteve të energjisë solare.

Realizimi i intervenimeve të lartpërmënuara dhe lansimi i dritares garantuese për financimin e projekteve të energjisë së ripërtëritshme solare, do të hap rrugë për rritjen e kufijve të tregut kreditor për bankat komerciale në Kosovë, ndërsa në të njëjtën kohë duke katalizuar sektorin e energjisë së ripërtëritshme do të ndikojë pozitivisht në përmirësimin e mjedisit në të cilin jetojmë.

PJESA V



AKTIVITETET GJATË VITIT 2019

LIDHJA E MARRËVESHJEVE TË REJA

SHKURT 2019

FONDI KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE E ZBATON DRITAREN AGRO

FKGK-ja e zbaton në tërësi Dritaren Agro pas nënshkrimit të marrëveshjes së garancisë me TEB Bankën dhe Bankën Ekonomike duke hyrë në marrëdhënie kontraktuale me të gjitha institucionet partnere financiare.



MAJ 2019

CEREMONIA E PËRVJETORIT DHE NËNSHKRIMIT TË MARRËVESHJES ME EIF

Në përvjetorin e tretë të themelimit, FKGK dhe EIF, pjesë e Bankës Evropiane për Investime (EIB), e nënshkruajnë Marrëveshjen e Garancisë së Programit COSME të Bashkimit Evropian për mbështetje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM).





SHTATOR/TETOR 2019

NËNSHKRIMI I MARRËVESHJEVE ME IFP-TË

FKGK-ja i nënshkruan marrëveshjet e garancisë me të gjitha IFP-të lidhur me programin COSME, me ç'rast nis zbatimi i këtij Programi. Po ashtu, gjatë vitit 2019, FKGK-ja nënshkroi marrëveshje për rritje të limitit për garancitë kreditore me BPB-në, RBKO-në, TEB-in dhe BEK-un. Marrëveshjet me limite të reja bankave do t'ua mundësojnë bankave që ta zgjerojnë më tej kredidhënien, ndërsa NMVM-ve do t'u ofrojë qasje më të lehtë në financa.



TETOR 2019

NËNSHKRIMI I MARRËVESHJES PËR ZBATIM FKGK/MFK

FKGK dhe MFK i mbështetur nga MCC, nënshkruajnë Marrëveshjen për Zbatim për energjinë e ripërtëritshme-solare. Marrëveshja synon rritjen e kreditimit dhe investimeve në sektorin e energjisë solare e cila do të ndikojë pozitivisht në përmirësimin e mjedisit në të cilin jetojmë.



DHJETOR 2019

NËNSHKRIMI I MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT ME BQK

FKGK-ja e nënshkruan Marrëveshjen e re të Bashkëpunimit me BQK-në. Memorandumi do t'i sjellë Fondit lehtësi edhe më të madhe në rritjen e efikasitetit të proceseve të brendshme krahas ndarjes së informacioneve në mes të FKGK-së dhe BQK-së.

PUNËTORITË SEMINARET

Gjatë vitit 2019, FK GK-ja mori pjesë në konferenca të ndryshme, në të cilat e prezantoi rolin e skemave garantuese, ndikimin e tyre në zhvillimin ekonomik në përgjithësi si dhe arritjet e objektivave të FK GK-së. Disa nga këto ngjarje janë paraqitur më poshtë:



JANAR 2019

KONFERENCA PËR FINANCIMIN E BUJQËSISË E ORGANIZUAR NGA IFC

FK GK-ja mori pjesë në Konferencën për Financimin e Bujqësisë të organizuar nga IFC, përkatësisht në panelin e diskutimit për mundësitë e financimit për sektorin e bujqësisë.



SHTATOR 2019

TRYEZA E RRUMBULLAKËT PËR INFORMALITETIN NË SEKTORIN E BUJQËSISË

FK GK-ja, së bashku me KfW-në, e organizuan Tryezën e Rrumbullakët për Informalitetin në Sektorin e Bujqësisë dhe ndikimin e tij në rritjen e qasjes në financa për agrobizneset.



SHTATOR 2019

KONFERENCA PËR PREZANTIMIN E STUDIMIT BOTTLENECK 2019

FKGK-ja mori pjesë në Konferencën për Prezantimin e Studimit Bottleneck 2019 të organizuar nga Oda Ekonomike e Kosovës, përkatësisht në panelin e diskutimit për qasjen në financa dhe informalitetin.



TETOR 2019

EDICIONI I KATËRT I FESTIVALIT TË GJELBËR

FKGK-ja mori pjesë në Festivalin e Gjelbër, përkatësisht në panelin e diskutimit për Financimin dhe Mbështetjen e Projekteve për Energjinë Efiçiente dhe atë të Ripërtëritshme – sektori privat në Kosovë.



DHJETOR 2019

NGJARJA E ORGANIZUAR NGA D4D PËR FKGK

FKGK-ja mori pjesë në Sallonin e së Martës të organizuar nga D4D, përkatësisht në diskutimin për temën "Si të kemi qasje më të lehtë në financa".

TRAJNIMET ORIENTUESE DHE FRESKUESE ME INSTITUCIONET PARTNERE FINANCIARE

Trajnimet orientuese dhe freskuese me IFP-të synojnë ta ngritin vetëdijen e personelit të IFP-ve për shërbimet e FK GK-së, karakteristikat e garancive kreditore si dhe ndryshimet dhe të mirat që këto shërbime ua sjellin të gjitha palëve përkatëse, përkatësisht IFP-ve, NMVM-ve dhe ekonomisë në përgjithësi.

Gjatë vitit 2019, personeli i FK GK-së i ka zhvilluar një sërë trajnimesh orientuese për zyrtarët kreditorë përgjegjës për analizimin e kredive dhe riskut që bashkëveprojnë direkt me FK GK-në (personelin dhe sistemin) si dhe me klientët (NMVM-të). Këto trajnime ishin specifike për zbatimin e Programit COSME dhe Dritares Agro, ndërsa gjatë tyre u ofrua një kurs freskues për produktet standarde.

Në tabelën e mëposhtme (Tabela 3) është paraqitur një përmbledhje e trajnimeve për stafin e IFP-ve:

Tabela 3. Përmbledhje e trajnimeve për IFP-të

LLOJI	NUMRI I TRAJNIMEVE	NUMRI I PERSONELIT
TRAJNIM ORIENTUES DHE MIS	7	22
TRAJNIM ORIENTUES PËR DRITAREN AGRO DHE TRAJNIM FRESKUES	9	98
TRAJNIM ORIENTUES PËR COSME DHE DRITAREN AGRO	14	206
TOTALI	30	326

MBLEDHJET E BORDIT TË DREJTORËVE DHE KOMITETEVE PËRKATËSE

MBLEDHJET E BORDIT TË DREJTORËVE TË FK GK-SË

Gjatë vitit 2019, Bordi i Drejtorëve i FK GK-së mbajti gjithsej katër (4) mbledhje, nga të cilat tri ishin mbledhje të rregullta dhe një mbledhje ishte e jashtëzakonshme. Në mbledhjet e bordit u morën disa vendime të rëndësishme për zhvillimin e mëtutjeshëm të FK GK-së dhe të marrëdhënieve të FK GK-së me palët e treta. Meqë njëra ndër vlerat institucionale është transparenca, prej nga ne shpalosim informata për praktikën e punës, politikat dhe rezultatet financiare e operative, gjatë vitit 2019, në mbledhjet e Bordit të Drejtorëve, në pjesën e hapur për publikun, kishim mysafir edhe Ministrin për Zhvillim Ekonomik si dhe Kryeshefin Ekzekutiv të Shoqatës së Bankave të Kosovës.

MBLEDHJET E KOMITETIT PËR MENAXHIM TË RISKUT KREDITOR DHE TË KOMITETIT TË AUDITIMIT

Gjatë vitit 2019, Komiteti për Menaxhim të Riskut Kreditor (MRK) i mbajti katër (4) mbledhje të rregullta dhe Komiteti i Auditimit (KA) i mbajti katër (4) mbledhje të rregullta. Në këto mbledhje, komitetet përkatëse morën vendime dhe rekomandime për menaxhmentin e FK GK-së dhe për miratim përfundimtar nga Bordi i Drejtorëve i FK GK-së. Në tabelën në vijim (Tabela 4) janë paraqitur mbledhjet e Bordit dhe të komiteteve ndihmëse të Bordit të Drejtorëve të FK GK-së:

Tabela 4. Përmbledhje e mbledhjeve të Bordit të Drejtorëve dhe komiteteve ndihmëse

Orari i mbledhjeve të Bordit	Pjesëmarrja e anëtarëve të Bordit	Numri i temave të diskutuara	Numri i vendimeve të marra
Prill 2019	7/7	5	4
Maj 2019	7/7	5	5
Gusht 2019	7/7	5	4
Nëntor 2019	7/7	3	1
Gjithsej:		18	14
Orari i mbledhjeve i KMR-së	Pjesëmarrja e anëtarëve të KMR-së	Numri i temave të diskutuara	Numri i vendimeve/rekomandimeve të marra
Maj 2019	4/4	6	3
Korrik 2019	4/4	5	3
Nëntor 2019	4/4	1	0
Dhjetor 2019	4/4	1	0
Gjithsej:		13	6
Orari i mbledhjeve i KA-së	Pjesëmarrja e anëtarëve të KA-së	Numri i temave të diskutuara	Numri i vendimeve/rekomandimeve të marra
Maj 2019	4/4	6	4
Korrik 2019	4/4	5	5
Nëntor 2019	4/4	4	0
Dhjetor 2019	4/4	1	1
Gjithsej:		16	10

PJESA VI



PASQYRAT FINANCIARE TË AUDITUARA

**FONDI KOSOVAR PËR GARANCI
KREDITORE**

**Raporti i Auditorit të Pavarur dhe
Pasqyrat Financiare për vitin që ka
përfunduar më 31 dhjetor 2019**

PËRMBAJTJA

	Faqe
Raporti i Auditorit të Pavarur	1
Pasqyra e Pozicionit Financiar	3
Pasqyra e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse	4
Pasqyra e Ndryshimeve në Bilancin e Fondit	5
Pasqyra e Rrjedhës së Parasë	6
Shënimet e Pasqyrave Financiare	7 - 30



Raporti i Auditorit të Pavarur

Grant Thornton LLC
Rr. Rexhep Mala 18
10 000 Pristina
Kosovo

T +381 38 247 771
+381 38 247 801
F +381 38 247 802
www.grantthornton-ks.com

Për Bordin e Drejtorëve të Fondit Kosovar Për Garanci Kreditore

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Fondit Kosovar Për Garanci Kreditore ("Fondi"), të cilat përfshijnë pasqyrën e të pozicionit financiar më 31 dhjetor 2019, pasqyrën të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyrën e rrjedhës së pasqyrës për vitin e përfunduar, si dhe shënimet për pasqyrat financiare, duke përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme të kontabilitetit.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Fondit më 31 Dhjetor 2019, si dhe performancën e saj financiare dhe rrjedhën e pasqyrës për vitin e përfunduar, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF-të).

Bazat për Opinion

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Nderkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë të përshkruara në mënyrë më të detajuar në paragrafin e raportit tonë Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Fondi në përputhje me kërkesat etike të cilat janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave financiare në Kosovë dhe ne kemi përmbushur edhe përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe të Kodit BSNEK. Ne besojmë që evidenca e auditimit që ne kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Çështje të tjera

Pasqyrat financiare të veçanta të Fondit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018 janë audituar nga një auditor tjetër i cili shprehu një opinion të pa modifikuar mbi këto pasqyra më 25 prill 2019.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezentimin e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme, që konsiderohen të nevojshme nga menaxhmenti për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

Gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Fondit për të vazhduar se përmbushuri parimin e vijimësisë, duke shpalosur, nëse është e zbatueshme, çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë e biznesit dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë, përveç kur menaxhmenti ka për qëllim të likujdijë Fondin ose të ndërpresë aktivitetet, ose nuk ka ndonjë mundësi tjetër përveç se të veprojë në këtë mënyrë.

Personat që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të Fondit.

Përgjegjësia e Auditorit për auditimin e pasqyrave financiare

Qëllimet tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin që pasqyrat financiare në terësi nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë si pasojë e mashtrimeve ashtu edhe e gabimeve, dhe lëshimin e një raporti auditimi i cili përmban opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk është garancion i asaj që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të, do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të lindin si rezultat i mashtrimeve ose gabimeve dhe konsiderohen materiale nëse individualisht, ose të bashkuara, mund të pritët në mënyrë të arsyeshme që të ndikojnë në vendimet ekonomike të shfrytëzuesve të pasqyrave financiare, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizëm profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë riskun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, si pasojë nga mashtrimet apo edhe si pasojë e gabimeve, dizajnojmë dhe kryejmë procedura të auditimit të cilat i përgjigjen këtyre risqeve dhe marrim evidenca të auditimit të cilat janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Risku i mos-zbulimit të një anomalie materiale e cila rrjedhë nga mashtrimi është më i madh sesa i atij që rrjedhë nga gabimi, pasi që mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm, që është relevante me auditimin në mënyrë që të dizajnojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme me rrethanat, mirëpo jo me qëllim për dhënien e një opinionit mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të Fondit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël si dhe shpalosjet e bëra nga menaxhmenti.
- Nxjerrim përfundime në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës së hipotezës së vijimësisë së kontabilitetit, duke u bazuar në evidencat e auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të shkaktojnë dyshim të lartë që Fondi mund të vazhdojë operimin. Nëse ne vijmë në përfundim se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit në shpalosjet e pasqyrave financiare ose nëse shpalosjet e tilla janë jo të përshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat tona të auditimit të siguruara deri në datën e raportit tonë. Sidoqoftë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të shkaktojnë që Fondi të ndërpresë së pëmbushuri parimin e vijimësisë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare të prezentojnë transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me ata që janë të ngarkuar me qeverisjen e Fondit Kosovë Për Garanci Kreditorë, përpos të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollet e brendshme që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Grant Thornton LLC
Prishtinë,
3 shtator 2020



Suzana Stavrikj

Auditor Ligjor

	Shënimet	Më 31 dhjetor 2019 (euro)	Më 31 dhjetor 2018 (euro)
ASETET			
Paraja dhe ekuivalentët e saj	4	735,567	961,039
Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera	5	381,374	289,618
Depozitat	6	16,891,934	15,741,506
Asetet me të drejtë përdorimi	7	26,927	-
Prona, impiantet dhe pajisjet	8	2,032	7,591
Asetet e paprekshme	9	40,203	43,874
GJITHSEJ ASETET		18,078,037	17,043,628
DETYRIMET DHE EKUITETI			
Shpenzimet akruale		9,206	13,613
Detyrimet e qirasë	7	27,468	-
Rezervat e humbjeve nga garancionet e kredive		688,299	299,683
Të hyrat e shtyra nga asetet e dhuruara	10	32,110	40,847
Tarifat akruale të garancisë		549,819	402,684
Gjithsej detyrimet		1,306,902	756,827
Ekuiteti			
Kapitali	11	15,790,921	15,790,921
Fitimi i akumuluar		980,214	495,880
Gjithsej ekuiteti		16,771,135	16,286,801
GJITHSEJ EKUITETI DHE DETYRIMET		18,078,037	17,043,628

Autorizohet për lëshim nga menaxhmenti dhe nënshkruar në emër të tij më 03 shtator 2020.

Besnik Berisha
Drejtör Menaxhues



Vjosa Balaj
Menaxhere e Lartë e Financave

Shënimet shoqëruese në faqet 7 deri 30 përbëjnë një pjesë integrale të këtyre pasqyrave financiare.

	Shënimet	Për vitin 31 dhjetor 2019 (euro)	Për vitin 31 dhjetor 2018 (euro)
Tarifat e garancisë	12	814,289	463,714
Të ardhurat tjera	13	461,242	392,316
Gjithsej të ardhurat		1,275,531	856,030
Shpenzimet e personelit	14	(176,188)	(163,141)
Zhvlerësimi dhe Amortizimi	7,8,9	(43,647)	(33,162)
Shpenzimet operative	15	(100,395)	(128,546)
Provizioni neto për humbje nga garancionet	16	(470,967)	(211,169)
Fitimi i vitit		484,334	320,012
Të Ardhurat tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin		484,334	320,012

Shënimet shoqëruese në faqet 7 deri 30 përbëjnë një pjesë integrale të këtyre pasqyrave financiare.

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore
Pasqyra e Ndryshimeve në Bilancin e Fondit
Për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor 2019

	Kapitali (euro)	Fitimi i Akumuluar (euro)	Gjithsej (euro)
Më 1 janar 2018	15,790,921	175,868	15,966,789
Fitimi e vitit	-	320,012	320,012
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-
Më 31 dhjetor 2018	15,790,921	495,880	16,286,801
Më 1 janar 2019	15,790,921	495,880	16,286,801
Fitimi i vitit	-	484,334	484,334
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-
Më 31 dhjetor 2019	15,790,921	980,214	16,771,135

Shënimet shoqëruese në faqet 7 deri 30 përbëjnë një pjesë integrale të këtyre pasqyrave financiare.

Shënimet	Për vitin 31 dhjetor 2019 (euro)	Për vitin 31 dhjetor 2018 (euro)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operuese:		
Fitimi i vitit	484,334	320,012
Korrigjimet për:		
Zhvierësimin	8,9 25,696	33,162
Interesin në depozita	(245,050)	(180,513)
	264,980	172,661
Lëvizjet në kapitalin qarkullues:		
Rritja në të arkëtueshmet tjera	(91,756)	(207,446)
Rritja në akrualet e tarifave të garancive	147,135	236,049
Rritja në rezervat e humbjeve nga garancionet	388,616	211,170
(Zvogëlimi)/Rritja në të hyrat e shtyra nga asetet e dhuruara	(8,737)	(31,869)
Rritja në akruale	(4,406)	10,368
Rritja në detyrime të qirasë	541	-
Neto paraja e (përdorur)/gjeneruar në aktivitetet operuese	696,373	390,933
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese:		
Blerja e asetëve afatgjata	8,9 (16,467)	(6,088)
Rritja në depozitat me afat	(1,058,045)	(7,062,000)
Interesi i arkëtuar nga depozitat	152,667	70,500
Neto paraja e përdorur nga aktivitetet investuese	(921,845)	(6,997,588)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese		
Kapitali i paguar	-	-
Neto paraja e gjeneruar nga aktivitetet financuese	-	-
Neto (zvogëlimi)/rritja e parasë dhe ekuivalentëve të saj gjatë vitit	(225,472)	(6,606,655)
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit	961,039	7,567,694
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit	4 735,567	961,039

Shënimet shoqëruese në faqet 7 - 30 përbëjnë një pjesë integrale të këtyre pasqyrave financiare.

1. TË PËRGJITHSHME

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore ("FKGK" ose "Fondi") është institucion i pavarur dhe i qëndrueshëm që lëshon garanci për institucionet financiare për të mbuluar rrezikun për kreditë e NMVM-ve (Ndërmarrjeve Mikro, të Vogla dhe të Mesme).

FKGK u krijua, për shkak të një iniciative të përbashkët midis Donatorëve Ndërkombëtarë në Kosovë (kryesisht USAID dhe KFW) dhe Qeverisë së Kosovës, në janar 2016, bazuar në Ligjin për Themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore.

Përmes "Ligjit për themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore" Ligji Nr. 05 / L-057 themeloi FKGK-në si një institucion të pavarur, jo-fitimprurës, publik, entitet autonom, juridik dhe përcaktoi autoritetin, strukturën, qeverisjen, operacionet e tij, fushëveprimin, politikat dhe procedurat për lëshimin e garancioneve të kredisë.

Ligji themelues për FKGK-në u inicua nga MTI (Ministria e Tregtisë dhe Industrisë), ndërsa USAID në Kosovë, përmes Programit EMPOWER Mbështetja e Kredisë (ECS) mbështeti institucionin për t'u bërë funksional. Ligji hyri në fuqi më 23 janar 2016. Kapitali i FKGK-së përbëhet nga fonde të dhuruara nga MTI, USAID dhe KfW.

FKGK është krijuar për të ndihmuar në plotësimin e nevojës për qasje të shtuar në financa për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme në Kosovë, me qëllim të krijimit të vendeve të punës, rritjen e prodhimit vendor dhe shërbimeve të shtuara me vlerë, dhe përmirësimin e bilancit tregtar dhe rritjen e mundësive të financimit për NMVM-të.

FKGK është person i pavarur, autonom, juridik, i themeluar me Ligj, me personalitet të plotë juridik, dhe një identitet juridik që është i veçantë nga Bordi Menaxhues i FKGK-së dhe Ekzekutivët.

FKGK drejtohet nga Bordi i Drejtorëve i përbërë nga shtatë anëtarë të cilët bashkërisht kanë shumë vite përvojë në menaxhimin financiar, menaxhimin e rrezikut, të drejtën tregtare e financiare, si dhe auditimin. Bordi siguron udhëheqje dhe mbikëqyrje për të gjitha aktivitetet e FKGK-së.

FKGK-ja është themeluar me qëllim të sigurimit të pjesshëm të garancive të kredive për institucionet financiare, për kreditë që i jepen NMVM-ve, deri në shumën e mbulimit të përcaktuar me LFKGK dhe Marrëveshjes së Garancisë ndërmjet FKGK-së dhe institucionit financiar.

Për qëllimet e veprimtarisë kryesore, FKGK-ja është përgjegjëse për:

- a. Lëshimin e Garancive Kreditore në përputhje me LFKGK-në dhe politikat e brendshme të miratuara nga Bordi i Drejtorëve.
- b. Vendosjen e kushteve për regjistrimin e institucioneve të kualifikuara financiare të Kosovës në FKGK, sipas Politikës për Regjistrimin e Institucioneve Financiare.
- c. Caktimin e kushteve për lëshimin e Garancive Kreditore nga FKGK-ja.
- d. Caktimin e Tarifave të Garancive të FKGK-së.
- e. Depozitimin apo investimin e drejtpërdrejtë, apo përmes delegimit të autorizimeve, të aseteve të FKGK-së brenda kufizimeve të LFKGK-së.
- f. Pagesën e Shumave të pagueshme për Garancitë Kreditore për institucionet financiare të regjistruara në pajtim me dispozitat e LFKGK-së dhe Marrëveshjes së Garancisë, në përputhje me dispozitat e LFKGK-së dhe Politikave për Trajtimin e Kërkesave.

1. TË PËRGJITHSHME (VAZHDIM)

Kapitali minimal i FKKG-së është 300,000.00 Euro, sipas nenit të 10 të LFKKG-së (Ligji për Fondin Kosovar për Garanci Kreditore). Organet qeverisëse të FKKG-së janë Bordi i Drejtorëve dhe Drejtori Menaxhues. Bordi i Drejtorëve është organi më i lartë drejtues i FKKG-së. Numri fiskal i FKKG-së është 601642061.

Operacionet e FKKG-së dhe të gjitha aktivitetet administrative janë të pavarura që nga data 10 qershor 2017 dhe janë nën menaxhimin e Fondit të mbështetur nga asistencë teknike e USAID-it.

Më 6 dhjetor 2017 Fondi për Garantimin e Kredive të Kosovës (FKKG) nënshkroi Marrëveshjen e Garancisë me Agjencinë Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar (Sida), përfaqësuar nga Ambasada e Suedisë në Prishtinë.

Më 14 maj 2019 Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKKG) nënshkroi Marrëveshjen e Garancisë me Fondin European Investues nën programin COSME LGF (loan guarantee facility).

Mbështetja e portofolit të garantuar të FKKG-së nga Sida dhe COSME, do të rrisë më tej aftësinë e Fondit për të siguruar një nivel më të lartë të garancive të kredisë, duke rritur në të njëjtën kohë qëndrueshmërinë financiare të sektorit. Qëndrueshmëri do të reflektojë në lehtësimin e ndërmjetësimit financiar, duke rritur kështu qasjen në financimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, me qëllim të promovimit të zhvillimit ekonomik dhe krijimit të vendeve të punës për gra, burra dhe të rinjtë e të gjitha etnive në Kosovë.

2. POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT

2.1 Baza e përgatitjes dhe deklarata e pajtueshmërisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), siç janë nxjerrë nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK). Pasqyrat financiare janë përgatitur me anë të bazave të vlerësimit të specifikuara nga SNRF-ja për çdo lloj aset, detyrimi, të ardhurash apo shpenzimesh. Bazat e vlerësimit janë të përshkruara në hollësi në Shënimin si me poshtë.

Përgatitja e këtyre pasqyrave financiare në përputhje me IFRS-në kërkon përdorimin e disa vlerësimeve kritike të kontabilitetit. Gjithashtu kërkon nga menaxhmenti të shfrytëzojë gjykimin e tij në procesin e zbatimit të politikave kontabël të Fondit. Fushat ku janë bërë gjykime dhe vlerësime të rëndësishme gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare dhe efektet e tyre shpalosen në shënimin 3.8.

2.1.1 Standartet dhe Interpretimet efektive në periudhën aktuale

Ndryshimet e reja në vijim të standardeve ekzistuese të lëshuara nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit (BSNK) janë efektive për periudhën aktuale të raportimit:

• SNRF 16 “Qiratë;” (efektive për periudhën vjetore që fillon në ose pas 1 janarit 2019)

Standardi është efektiv për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 janarit 2019. Aplikimi i mëparshëm lejohet nëse SNRF 15 Të Ardhurat nga Kontratat me Klientë është aplikuar gjithashtu. SNRF 16 përcakton parimet për njohjen, matjen, prezentimin dhe shpalosjen e qirave për të dy palët e një kontrate, d.m.th. konsumatori (‘qiramarrësi’) dhe furnizuesi (‘qiradhënësi’). Standardi i ri kërkon që qiramarrësit të njohin shumicën e qirave në pasqyrat e tyre financiare. Qiramarrësit do të kenë një model të vetëm të kontabilitetit për të gjitha qiradhëniet, me përjashtime të caktuara. Kontabiliteti i qiradhënësit në thelb është i pandryshuar.

2. POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

2.1 Baza e përgatitjes dhe deklarata e pajtueshmërisë (vazhdim)

2.1.1 Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale (vazhdim)

Fondi njeh një aset me të drejtë përdorimi dhe një detyrim të qirasë në datën e fillimit të qirasë. Aseti i përdorimit të së drejtës fillimisht matet me koston, e cila përfshin shumën fillestare të detyrimit të qirasë të rregulluar për çdo pagesë të qirasë të bërë në ose para datës së fillimit, plus çdo kosto fillestare direkte të ndodhur si dhe një vlerësim të kostove për çmontimin dhe heqjen e asetit paraprak ose për të rivendosur asetin paraprak apo vendin në të cilin është vendosur, më pak se çdo stimulim i marrë me qira.

Aseti me të drejtë përdorimi zhvlerësohet më pas duke përdorur metodën drejtëvizore nga data e fillimit deri më herët në fund të jetës së dobishme të asetit me të drejtë përdorimi ose në fund të afatit të qirasë.

Jetëgjatësia e vlefshme e dobishme e asetit me të drejtë përdorimi përcaktohet në të njëjtën bazë si ato të pronave dhe pajisjeve. Për më tepër, asetit me të drejtë përdorimi zvogëlohet në mënyrë periodike nga zhvlerësimet e humbjeve, nëse ka, dhe rregullohet për rivlerësime të caktuara të detyrimit të qirasë.

Jetëgjatësia e vlefshme e dobishme e asetit me të drejtë përdorimi përcaktohet në të njëjtën bazë si ato të pronave dhe pajisjeve. Për më tepër, asetit me të drejtë përdorimi zvogëlohet në mënyrë periodike nga zhvlerësimet e humbjeve, nëse ka, dhe rregullohet për rivlerësime të caktuara të detyrimit të qirasë.

Detyrimi i qirasë fillimisht matet me vlerën aktuale të pagesave të qirasë, të cilat nuk paguhën në datën e fillimit, duke u zbritur duke përdorur normën e interesit të nënkuptuar në qira ose, nëse kjo normë nuk mund të përcaktohet me lehtësi, shkalla e huamarrjes shtesë e Fondit.

Pagesat e qirasë të përfshira në matjen e detyrimit të qirasë përfshijnë si më poshtë:

- pagesa fikse, përfshirë pagesa fikse në substancë.
- pagesa të ndryshueshme të qirasë që varen nga një indeks ose një normë, e matur fillimisht duke përdorur indeksin ose kursin, në datën e fillimit.
- shumat që pritet të paguhën nën një garanci të vlerës së mbetur; dhe
- çmimi i ndryshueshëm nën një opion të blerjes kur kompania është e gatshme për të ushtruar, pagesat e qirasë në një periudhë rinovimi opsionale nëse Kompania është e sigurt se do të ushtrojë një opion zgjatjeje, dhe gjobat për përfundimin e parakohshëm të qirasë, përveç nëse Kompania është arsyeshëm e sigurt që nuk do të përfundojë më herët.

Detyrimi i qirasë matet me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Rivlerësohet kur ka një ndryshim në pagesat e ardhshme të qirasë që vijnë nga një ndryshim në një indeks ose normë, nëse ka një ndryshim në vlerësimin e Kompanisë për shumën që pritet të paguhet nën një garanci të vlerës së mbetur, ose nëse Kompania ndryshon vlerësimin e saj nëse do të ushtrojë një mundësi blerjeje, zgjatjeje ose përfundimi.

Kur detyrimi i qirasë rivlerësohet në këtë mënyrë, një rregullim përkatës bëhet në vlerën kontabël të asetit të së drejtës së përdorimit ose regjistrohët në fitim ose humbje nëse vlera kontabël e asetit të së drejtës së përdorimit është zvogëluar në zero.

Kompania paraqet asetet me të drejtë përdorimi për të cilat nuk plotësojnë përkufizimin e pasurisë së investimit në "pronë, bimë dhe pajisje" dhe detyrimet e qirasë në "detyrime të tjera" në pasqyrën e pozicionit financiar (shënimi 9).

Në kalimin në SNRF 16, niveli mesatar i ponderuar i huamarrjes në rritje i aplikuar për detyrimet e qirasë të njohura sipas SNRF 16 ishte 6.49%.

Fondi përdor një ose më shumë nga përdoruesit praktikë të mëposhtëm sipas SNRF 16.C10, duke e aplikuar atë në bazë të qirasë:

- Përdorimi i një norme të vetme zbritje në një portofol të qirave me karakteristika të ngjashme.
- Përshtatjen e asetit me të drejtë përdorimi për çdo provizion të rëndë të njohur të qirasë, në vend që të bëjë një rishikim të zhvlerësimit.

2. POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

2.1 Baza e përgatitjes dhe deklarata e pajtueshmërisë (vazhdim)

2.1.1 Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale (vazhdim)

- Aplikimi një përjashtimi të njohjes për qiratë për të cilat afati i qirasë përfundon brenda 12 muajve nga data e aplikimit fillestar dhe qirave të aseteve me vlerë të ulët. Kompania njihet
- Duke përjashtuar kostot fillestare direkte nga matja e asetit të së drejtës së përdorimit.
- Përdorimi i mbikëqyrjes, siç është përcaktimi i afatit të qirasë nëse kontrata përmban mundësi për zgjatjen ose përfundimin e qirasë.

Politika e zbatueshme nga 1 janari 2019

Në fillimin e një kontrate, Kompania vlerëson nëse një kontratë është, ose përmban, një qira. Një kontratë është, ose përmban, një qira nëse kontrata përcjell të drejtën për të kontrolluar përdorimin e një asetit të identifikuar për një periudhë në këmbim të vlerësimit. Për të vlerësuar nëse një kontratë përcjell të drejtën për të kontrolluar përdorimin e një asetit të identifikuar, Kompania vlerëson nëse:

- kontrata përfshin përdorimin e një asetit të identifikuar - kjo mund të specifikohet në mënyrë të qartë ose të nënkuptuar dhe duhet të jetë e veçantë fizikisht ose të përfaqësojë në thelb të gjithë aftësinë e një aktivi fizikisht të veçantë. Nëse furnizuesi ka të drejtë substanciale zëvendësimi, atëherë aktivi nuk identifikohet.
- Ndërmarrja ka të drejtë të sigurojë në tërësi të gjitha përfitimet ekonomike nga përdorimi i asetit gjatë gjithë periudhës së përdorimit; dhe
- Kompania ka të drejtë të përcaktojë përdorimin e asetit. Kompania ka këtë të drejtë kur ka të drejtat e vendimmarrjes që janë më të rëndësishme për ndryshimin se si dhe për çfarë qëllimi përdoret aktivi. Në raste të rralla kur vendimi është i paracaktuar se si dhe për çfarë qëllimi asetit është përdorur, Kompania ka të drejtë të përcaktojë përdorimin e asetit nëse:
- Kompania ka të drejtë të drejtojë asetin; ose
- Ndërmarrja dizajnoi asetin në atë mënyrë që paracakton se si dhe për çfarë qëllimi do të përdoret.

Kjo politikë zbatohet për kontratat e lidhura, ose ndryshuar, në ose pas 1 janarit 2019.

Në fillimin ose në rivlerësimin e një kontrate që përmban një komponentë të qirasë, Kompania shpërndanë vlerësimin në kontratë për secilën komponentë të qirasë bazuar në çmimet e tyre të pavarura relative. Sidoqoftë, për qiradhëniet e tokës dhe ndërtesave në të cilat është qiramarrëse, Kompania ka zgjedhur të mos ndajë komponentën jo-qira dhe të japë llogari për komponentët e qirasë dhe të jo-qirasë, si një komponentë të vetme të qirasë.

Politika e zbatueshme para 1 janarit 2019

Për kontratat e lidhura para 1 janarit 2019, Fondi vlerësoi Asetin e së Drejtës Përdorimit si të barabartë me Detyrimin e Qiradhënies. Në përcaktimin nëse marrëveshja ishte apo përmbante një qira bazuar në vlerësimin nëse:

- Përmbushja e marrëveshjes varej nga përdorimi i një pasurie ose pasurive specifike; dhe
- Marrëveshja përcjellte të drejtën për të përdorur asetin. Një marrëveshje transferonte të drejtën e përdorimit të aktivit nëse njëra nga të vijueshmet përmbushej:
 - i) blerësi kishte aftësinë ose të drejtën për të përdorur asetin duke marrë ose kontrolluar më shumë sesa një sasi të vogël të prodhimit.
 - ii) blerësi kishte aftësinë ose të drejtën për të kontrolluar qasjen fizike në aset, ndërsa merrte ose kontrollonte më shumë se një sasi të vogël të prodhimit; ose
 - iii) faktet dhe rrethanat treguan që ishte e largët që palët e tjera të merrnin më shumë sesa një sasi të vogël të prodhimit, dhe çmimi për njësi nuk ishte as i caktuar për njësi të prodhimit, as i barabartë me çmimin aktual të tregut për njësi të prodhimit.

• **Ndryshimet në SNRF 9 "Instrumentet Financiare"** - Karakteristikat e parapagimit me kompensim negativ (efektive për periudhat vjetore që fillojnë me ose pas 1 janarit 2019).

2. POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

2.1 Baza e përgatitjes dhe deklarata e pajtueshmërisë (vazhdim)

2.1.1 Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale (vazhdim)

Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 janarit 2019 me aplikimin e mëparshëm të lejuar. Ndryshon kërkesat ekzistuese në SNRF 9 në lidhje me të drejtat e shkëputjes për të lejuar matjen e kostos së amortizuar (ose, në varësi të modelit të biznesit, me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse) edhe në rastin e pagesave të kompensimit negativ.

• **Ndryshimet në SNK 19 “Përfitimet e Punonjësve”** - Ndryshimi i Planit, Reduktimi ose Zgjidhja (efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 janarit 2019)

Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019 me lejm të aplikimit të mëhershëm. Ndryshimet janë në rastet kur bëhet ndryshimi i planit, kufizimi ose shlyerja, atëherë është e detyrueshme që kostoja aktuale e shërbimit dhe interesi neto për periudhën pas rivlerësimit të përcaktohen duke përdorur supozimet e përdorura për rivlerësimin. Përveç kësaj, janë përfshirë ndryshime për të sqaruar efektin e një ndryshimi, kufizimi ose shlyerje të planit për kërkesat lidhur me vlerën maksimale të asetëve.

• **Ndryshimet në SNK 28 “Investimet në Shoqëritë dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta”** - Interesat afatgjata në Investimet në Shoqëritë dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019)

Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019 me lejm të aplikimit të mëhershëm. Sqaron që një njësi ekonomike zbaton SNRF 9 Instrumentet Financiare për interesat afatgjata në një Ndërmarrje Shoqërore ose Ndërmarrje të Përbashkët që krijon pjesë të investimit neto në shoqëri ose ndërmarrje të përbashkët, por për të cilat nuk zbatohet metoda e kapitalit neto.

• **Ndryshime në standarde të ndryshme për shkak të “Përmirësimeve në SNRF (cikli 2015-2017)”** që vijnë nga projekti vjetor i përmirësimit të SNRF (SNRF 3, SNRF 11, SNK 12 dhe SNK 23) kryesisht me qëllim të heqjes së mospërputhjeve dhe sqarimit të formulimeve (efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 janarit 2019).

BSNK ka nxjerrë Ciklin e Përmirësimeve Vjetore në SNRF 2015-2017, i cili është një përmbledhje e ndryshimeve në SNRF. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019.

Përmbledhja e BSNK-se ka nxjerrë Ciklin e Përmirësimeve Vjetore të SNRF 2015-2017 që është paraqitur më poshtë:

- SNRF 3 dhe SNRF 11: Ndryshimet në SNRF 3 sqarojnë se kur një njësi ekonomike merr kontrollin e një biznesi që është një operacion i përbashkët, ai rivlerëson interesat e mbajtura më parë në atë biznes. Ndryshimet në SNRF 11 sqarojnë se kur një njësi ekonomike fiton kontroll të përbashkët të një biznesi që është një veprim i përbashkët, njësia ekonomike nuk rivlerëson interesat e mbajtura më parë në atë biznes.
- SNK 12: Ndryshimet sqarojnë se të gjitha pasojat e tatimit mbi të ardhurat e dividendëve (d.m.th. shpërndarja e fitimit) duhet të njihen në fitim ose humbje, pavarësisht se si ndryshojnë tatimet.
- SNK 23: Ndryshimet sqarojnë se nëse ndonjë huamarrje specifike mbetet e papaguar pasi aktivi në fjalë është i gatshëm për përdorimin ose shitjen e tij të synuar, huamarrja bëhet pjesë e fondeve që një njësi ekonomike hua, në përgjithësi kur llogaritet norma e kapitalizmit në huamarrjet e përgjithshme.

• **IFRIC 23 “Pasiguria për Trajtimet e Tatimit mbi të Ardhurat”** (efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 janarit 2019).

Interpretimi është i efektshëm për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 janarit 2019 me

2. POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

2.1 Baza e përgatitjes dhe deklarata e pajtueshmërisë (vazhdim)

2.1.1 Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale (vazhdim)

aplikimin e mëparshëm të lejuar. Interpretimi adreson përcaktimin e fitimit të tatueshëm (humbje tatimore), bazave tatimore, humbjeve tatimore të papërdorura, kredive të pashfrytëzuara tatimore dhe niveleve të taksave kur ekziston paqartësi për trajtimet e tatimit mbi të ardhurat sipas SNK 12. Në mënyrë specifike konsiderohet: nëse trajtimet tatimore duhet të konsiderohen kolektive; supozime për ekzaminimet e autoriteteve tatimore; përcaktimi i fitimit të tatueshëm (humbje tatimore), bazave tatimore, humbjeve tatimore të papërdorura, kredive të pashfrytëzuara tatimore dhe niveleve tatimore; dhe efektin e ndryshimeve në fakte dhe rrethana. Miratimi i këtyre ndryshimeve në standardet ekzistuese nuk ka çuar në ndonjë ndryshim material në pasqyrat financiare të FKGK-së.

2.1.2 Standardet dhe interpretimet e lëshuara nga BSNK por ende jo efektive dhe jo të aplikuara më herët nga FKGK

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare në vijim janë standardet, rishikimet dhe interpretimet e mëposhtme por që nuk janë ende efektive:

- **SNRF 17 “Kontratat e sigurimit”** (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021)

- **Ndryshimet në SNRF 3 “Kombinime Biznesi”** - Përkufizimi i një Biznesi (efektive për kombinimet e biznesit për të cilat data e blerjes është në ose pas fillimit të periudhës së parë të raportimit vjetor që fillon në ose pas 1 janarit 2020 dhe për blerjet e pasurive që ndodhin në ose pas fillimit të asaj periudhe).

- **Ndryshimet në SNRF 9 “Instrumentet Financiarë”, SNK 39 “Instrumentet Financiarë: Njohja dhe Matja” dhe SNRF 7 “Instrumentet Financiarë: Shpalosjet”** Reforma e Standardit të Normës së Interesit (efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 janarit 2020),

- **Ndryshimet në SNRF 10 “Pasqyrat e Konsoliduara Financiare” dhe SNK 20 “Investimet në Shoqëritë dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta”** - Shitja ose Kontributi i Pasurive midis një Investitori dhe një Ndërmarrje të Bashkuar me të ose Ndërmarrje të Përbashkët dhe ndryshimet e tjera (data e hyrjes në fuqi shtyhet pafundësisht derisa të përfundohet projekti kërkimor mbi metodën e kapitalit neto),

- **Ndryshimet në SNK 1 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare” dhe SNK 8 “Politikat e Kontabilitetit, Ndryshimet në Vlerësimet e Kontabilitetit dhe Gabimet”** - Definicioni i Materialit (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020),

- **Ndryshimet në Referencat e Kornizës Konceptuale në Standardet e SNRF** (efektive për periudhat raportuese vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020).

FKGK ka zgjedhur të mos miratojë këto standarde, ndryshime në standardet ekzistuese dhe interpretime të reja përpara datave të tyre të efektshme.

2.2 Asetet Financiare dhe Detyrimet Financiare

Në shikim fillestar, një aset financiar klasifikohet si i matur me koston e amortizuar, FVOCI, ose FVTPL. Detyrimet financiare klasifikohen dhe maten me koston e amortizuar.

Një aset financiar matet me koston e amortizuar nëse plotëson të dy kushtet e mëposhtme dhe nuk është përcaktuar si në FVTPL:

- o aset i mbahet brenda një modeli biznesi, qëllimi i të cilit është të mbajë asete për të mbledhur flukset monetare kontraktuale; dhe

2. POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

2.2 Asetet Financiare dhe Detyrimet Financiare (vazhdim)

- o Kushtet kontraktuale të asetit financiar i japin rritje rrjedhës së parasë në data të specifikuar që janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit të principalit mbi shumën e mbetur.

Një instrument borxhi matet në FVOCI vetëm nëse i plotëson të dy kushtet e mëposhtme dhe nuk është përcaktuar si në FVTPL:

- o aktivi mbahet brenda një modeli biznesi, objektivi i të cilit arrihet si nga mbledhja e flukseve monetare kontraktuese ashtu edhe nga shitja e pasurive financiare; dhe
- o Kushtet kontraktuale të asetit financiar japin ngritje në datat e specifikuar të flukseve monetare që janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit mbi shumën kryesore të mbetur.

